

**METODOLOGJIA PER LLOGARITJEN E DETYRIMIT TË ENERJISË SË RINOVUESHME
DHE PROCEDURËN PER KOMPENSIMIN E PRODHUESVE ME PËRPARËSI TË
ENERJISË ELEKTRIKE**

Neni 1

Qëllimi

Kjo metodologji përcakton llogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme që u ngarkohet të gjithë klientëve fundorë nga furnizuesit e energjisë elektrike, si dhe procedurën për kompensimin e prodhuesve me përparësi nga Operatori i Energjisë së Rinovueshme (këtu e më poshtë - "OER") për nxitjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo metodologji është hartuar bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 7/2017 "Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme" dhe nenit 20 të Ligjit Nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar.

Neni 3

Përkufizimet

1. Në këtë metodologji termat e mëposhtëm kanë kuptimin vijues:

1. "ERE" do të thotë Enti Rregullator i Energjisë dhe është institucioni rregullator për sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në Shqipëri.

2. "Detyrimi i energjisë së rinovueshme" është një tarifë fikse që zbatohet për klientët fundorë, me sasinë përkatëse të energjisë elektrike të matur dhe të furnizuar nga furnizuesit e këtyre klientëve. Ky detyrim llogaritet si produkt i shumës totale të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë dhe bonusit të dhënë për nxitjen e burimeve të energjisë së rinovueshme, në proporcion me sasinë totale të energjisë elektrike të furnizuar nga furnizuesi tek klienti fundor.

3. "Operatori i energjisë së rinovueshme" është subjekti përgjegjës për faturimin dhe mbledhjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme të aplikuar për të gjithë klientët fundorë të energjisë elektrike.

4. "Kontratë për diferencë" është kontrata, modeli i së cilës miratohet nga Këshilli i Ministrave, ndërmjet Operatorit të Energjisë së Rinovueshme dhe prodhuesve të energjisë nga burimet e rinovueshme, i cili është shpallur ofertues i suksesshëm në procesin konkurrues, për të përfituar nga skema e mbeshtetjes, siç parashikohet në Neni 9 të ligjit nr. 7/2017 "Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme".
 5. "Furnizues" është një shoqëri e licencuar për të kryer aktivitetin e furnizimit.
 6. "Klient fundor" është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak.
 7. "Çmimi i Referencës" është një çmim i cili bazohet në tregun e organizuar të energjisë elektrike në Shqipëri, ose deri në krijimin e tij, në një treg të krahasueshëm të energjisë elektrike.
 8. "Prodhues me përparësi" është çdo prodhues që prodhon energji elektrike nga burime të energjisë së rinovueshme dhe në rastin e energjisë hidrike me një kapacitet të instaluar deri në 15 MW për një njësi gjeneruese dhe që përfiton nga skemat mbështetëse sipas dispozitave të ligjit nr. 7/2017 "Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme".
2. Për fjalët dhe termat që nuk përmenden shprehimisht në përkufizimet e renditura në paragrafin 1 të këtij neni, do t'u referohen termave dhe përkufizimeve të përcaktuara me Ligjin Nr. 7/2017 "Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme"; Ligji Nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë", i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 24.04.2016, I ndryshuar.

Neni 4

Roli dhe përgjegjësitë e OER

1. OER është përgjegjës për faturimin e detyrimit të BRE për të gjithë furnizuesit e energjisë elektrike, të cilët furnizojnë klientët fundorë.
2. OER është përgjegjës për mbledhjen e detyrimit të BRE-ve nga të gjithë furnizuesit e energjisë elektrike dhe për pagimin e këtij detyrimi të prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike.
3. OER do të ketë përgjegjësinë të mbledhë të dhëna nga të gjithë prodhuesit me përparësi të energjisë në lidhje me vëllimin e tyre vjetor të parashikuar të energjisë elektrike të prodhuar nga burime të rinovueshme. Pas mbledhjes së të dhënave, OER do të përmbledhë të dhënat e paraqitura nga të gjithë prodhuesit me përparësi të energjisë dhe do t'i paraqesë ato në ERE për të llogaritur detyrimin e energjisë së rinovueshme që do t'u ngarkohet të gjithë klientëve fundorë.
4. OER do të nënshkruajë një kontratë me çdo furnizues të energjisë elektrike i cili furnizon klientët fundorë, për mbledhjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme që u ngarkohet të gjithë klientëve fundorë të energjisë elektrike.

5. Kontrata e nënshkruar ndërmjet OER dhe furnizuesit përcakton një kuotë vjetore të vëllimeve të energjisë së rinovueshme (e ndarë në baza mujore) që do t'i shitet secilit furnizues të energjisë elektrike për klientët fundorë, si tarifë e detyrimit të energjisë së rinovueshme.
6. Kuota vjetore e përmendur në paragrafin 5 të këtij neni përcaktohet nga ERE në mënyrë proporcionale me portofolin e energjisë elektrike të furnizuar të secilit furnizues. Vëllimet e energjisë elektrike dhe kosto e energjisë së rinovueshme për secilin furnizues të energjisë elektrike do të merren parasysh gjatë llogaritjes së tarifave të energjisë elektrike për OSSH ose Furnizuesin e Shërbimit Universal.
7. OER do të krijojë një regjistër të të gjithë furnizuesve aktivë të energjisë elektrike që furnizojnë klientët fundorë dhe do ta përditësojë atë vazhdimisht.
8. OER do të krijojë një regjistër të prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike dhe do të përditësojë vazhdimisht regjistrin.

Neni 5

Roli dhe përgjegjësitë e furnizuesve të energjisë elektrike

1. Çdo furnizues i energjisë elektrike, i cili furnizon klientët fundorë, do të nënshkruajë një kontratë me OER për mbledhjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme që u ngarkohet të gjithë klientëve fundorë të energjisë elektrike.
2. Çdo furnizues i energjisë elektrike për klientët fundorë është përgjegjës për faturimin tek të gjithë klientët fundorë dhe për mbledhjen nga çdo klient fundor të detyrimit të energjisë së rinovueshme të faturuar nga OER, për nxitjen e burimeve të rinovueshme të energjisë.
3. Furnizuesi do të faturojë vlerën e detyrimit të energjisë së rinovueshme në lekë / kWh për të gjithë klientët fundorë, në përputhje me sasinë përkatëse të energjisë elektrike të furnizuar te ata.

Neni 6

Parashikimi vjetor i energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike

Deri në 15 nëntor të çdo viti, të gjithë prodhuesit me përparësi, të cilët kanë hyrë në operim, si dhe të gjithë prodhuesit me përparësi që planifikojnë të komisionojnë centralet e tyre elektrike në vitin pasardhës, do të paraqesin edhe te OER një parashikim vjetor të sasisë të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme që do të prodhohet në vitin e ardhshëm si dhe të ndarë në nivele mujore.

OER mbledh vëllimet totale të parashikuara të energjisë elektrike që do të gjenerohet nga burimet e rinovueshme të paraqitura nga të gjithë prodhuesit me përparësi dhe llogarit shumën totale të parave që do t'u shpërndahen prodhuesve me përparësi për vitin në vijim.

Bazuar në të dhënat e paraqitura nga prodhuesit me përparësi, OER parashikon buxhetin e përgjithshëm për nxitjen e energjisë nga burimet e rinovueshme dhe pagesat për kontratën për diferencë për secilin prodhues me përparësi në bazë vjetore, në përputhje me çmimet dhe kushtet e secilës kontratë bilaterale dhe legjislacionit në fuqi.

Brenda 1 Dhjetorit të çdo viti, përpara se ERE të marrë një vendim për tarifat dhe çmimet e energjisë elektrike, OER do t'i paraqesë ERE: llogaritjen e vëllimit të përgjithshëm të energjisë elektrike të parashikuar të gjenerohet në vitin pasardhës dhe shumën totale për shkak të prodhuesve me përparësi.

Neni 7

Llogaritja e detyrimit të energjisë së rinovueshme

ERE do të llogarisë vlerën e detyrimit të energjisë së rinovueshme në Lek / kWh të ngarkuar për të gjithë klientët fundorë në përputhje me sasinë përkatëse të energjisë elektrike të matur dhe furnizuar nga furnizuesit të këta klientë fundorë.

Ky detyrim do të llogaritet si produkt i sasisë totale të energjisë elektrike të prodhuar nga burime të rinovueshme të energjisë me bonusin e dhënë për nxitjen e burimeve të rinovueshme të energjisë në lidhje me sasinë totale të energjisë elektrike të furnizuar nga furnizuesit të klientët fundorë, sipas formulës së mëposhtme:

Detyrimi i BRE-ve [Lek / kWh] = (Prodhimi total i energjisë elektrike nga BRE * bonus [Lek / kWh]) / (Parashikimi i përgjithshëm i kërkesës së brendshme për energji elektrike [kWh])

ku:

Energjia totale e prodhuar nga BRE - do të jetë sasia e energjisë së gjeneruar nga prodhuesit ekzistues me përparësi të energjisë dhe prodhuesit e vegjël të energjisë që do të hyjnë në operim në të ardhmen.

Bonus - është diferenca midis çmimit të prodhuesve me përparësi të energjisë të aprovuar nga ERE në bazë vjetore dhe çmimit të referencës.

Çmimi i Referencës - do të konsiderohet çmimi HUPX DAM në ngarkesën bazë, derisa Bursa Shqiptare e Energjisë (APEX) të bëhet funksionale.

2. Në fund të çdo viti, ERE do të nxjerrë një vendim mbi vlerën e detyrimit të energjisë së rinovueshme të shprehur në Lekë / kWh që duhet të paguhet nga secili klient fundor i energjisë elektrike gjatë vitit pasardhës.

3. ERE do të komunikojë vendimin në një mënyrë transparente për të gjithë furnizuesit e energjisë elektrike dhe konsumatorët e përdorimit perfundimtar dhe duhet ta publikojë atë në shtypin e shkruar kombëtar për 3 (tre) ditë rresht.

Neni 8

Faturimi dhe pagesa e detyrimit të energjisë së rinovueshme si dhe mbështetja për prodhuesit me përparësi

1. Çdo faturë e energjisë elektrike e faturuar nga furnizuesi i energjisë elektrike duhet të përfshijë në mënyrë të qartë detyrimin e energjisë së rinovueshme të faturuar nga furnizuesi i tyre i energjisë elektrike.
2. Secili prodhues me përparësi do të faturojë OER me vlerën përkatëse sipas kontratës (marrëveshja e blerjes së energjisë ose kontrata për diferencë) bazuar në një konfirmim nga operatori i sistemit të shpërndarjes ose transmetimit mbi sasinë e energjisë së rinovueshme të injektuar në rrjetin e shpërndarjes ose transmetimit dhe të matur në baza mujore.
3. OER do të faturojë dhe mbledh nga çdo furnizues i energjisë elektrike vlerat përkatëse për nxitjen e energjisë së rinovueshme në baza mujore.
4. OER do të faturojë furnizuesit e energjisë elektrike brenda 7 (shtatë) ditëve pas marrjes së faturës mujore nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike.
5. Pagesa e faturave të lëshuara nga OER dhe të marra nga furnizuesit e energjisë elektrike do të bëhet brenda 20 ditëve nga marrja e faturës mujore të lëshuar nga OER.

6. Pagesa e faturave të lëshuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë dhe të marra nga OER do të bëhet brenda 30 ditëve nga marrja e faturës mujore nga prodhuesit me përparësi të energjisë.

Neni 9

Rregullimet e detyrimit të energjisë së rinovueshme

1. Çdo vit, ERE do të llogarisë diferencat midis vlerave dhe shumave të parashikuara dhe atyre të arritura për nxitjen e energjisë nga burimet e rinovueshme gjatë vitit të kaluar kalendarik.
2. Rezultatet do të publikohen për të gjithë palët e interesuara dhe do të përfshihen në rishikimin e detyrimit të energjisë së rinovueshme në periudhën e ardhshme rregullatore.

Neni 10

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Në rast të një mosmarrëveshje mbi vlerat përkatëse, palët kontraktuese në marrëveshjet midis Operatorit të Energjisë së Rinovueshme dhe prodhuesve me përparësi ose në marrëveshjet midis Operatorit të Energjisë së Rinovueshme dhe furnizuesve të energjisë elektrike, fillimisht do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur konfliktin me mirëkuptim midis palëve.
2. Nëse nuk gjendet asnjë zgjidhje për një mosmarrëveshje midis palëve në kontratat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, ERE do të veprojë si një autoritet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në përputhje me Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe “Rregullorja për Trajtimin e Ankesave të Paraqitura nga Klientët dhe Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve midis të Licencuarve, në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror”, miratuar nga Bordi i ERE-s. Nëse nuk gjendet ndonjë zgjidhje përsëri, palët do t’ia drejtojnë mosmarrëveshjen e tyre gjykatës kompetente.

Neni 11

Dispozitat kalimtare

1. Deri në krijimin e një tregu të organizuar të energjisë elektrike në Shqipëri, në llogaritjen e pagesave të parashikuara të "Kontratës për Diferencë" për prodhuesit e energjisë së rinovueshme që marrin mbështetje

në formën e “feed-in premium”, OER do të marrë parasysh një çmim të një tregu përkatës bazuar në një vendim të ERE.

2. Operatori i sistemit ose shoqëria publike që do të kryejë rolin e OER, derisa Këshilli i Ministrave të përcaktojë OER, do të mbajë llogari të ndara financiare për secilën veprimtari të rregulluar dhe të paraqesë një raport financiar në ERE, në lidhje me aktivitetin e nxitjes së energjive të rinovueshme deri më 31 Mars të çdo viti pasardhës.

Neni 12

Ndryshimi i metodologjisë

Kjo rregullore është objekt rishikimi me Vendim të Bordit të ERE sipas përcaktimeve të "Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE".

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo metodologji do të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.